



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 1195/9 Prot.

Tiranë, më 08/05/2016

V E N D I M

Nr. 48, Datë 08/05/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË MALLAKASTËR "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimin e administrimin e aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Bashkinë Mallakastër, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ballsh, Mallakastër është kryer auditim nga KLSH për periudhën deri më 31.12.2012 për të cilin është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet me shkresën nr.560/6, prot.datë 13.09.2013, të cilat nuk janë realizuar plotësisht. Konkretisht janë rekomanduar 16 masa organizative, 6 masa për

shpërblim dëmi në vlerën 1,108,650 lekë dhe 2 masa disiplinore. Nga masat organizative, dy masa nuk janë zbatuar, dy masa janë zbatuar pjesërisht.

Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, me shkresën nr. 560/6, prot. datë 13.09.2013.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Ballsh, Mallakastër është kryer auditim nga KLSH deri më 31.12.2012 dhe janë rekomanduar 6 (gjashtë) masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,108,650 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 521,692 lekë, ose 47% e shumës duke mbetur ende pa shlyer vlera 586,958 lekë.

Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për zbatimin e rekomandimeve për shpërblim dëmi nga 8 (tetë) persona në vlerën 586,958 lekë të pa realizuara për masat organizative të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, me shkresën nr. 560/6 prot., datë 13.09.2013, sipas listës cilësuar në faqen 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Veprimtaria e institucionit bazohet në rregulloren e brendëshme të hartuar në vitin 2013, në të cilën nuk janë të përcaktuara detyrat për secilin pozicion pune sipas strukturës, por vetëm detyrat e përgjithëshme të drejtorisë apo sektorit, nuk janë përcaktuar linjat dhe frekuenca e raportimit nga ana e menaxherëve të Titullari i institucionit. Nuk janë të pasqyruara në rregulloren e brendëshme detyrat që rrjedhin si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i cili ka shfuqizuar ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si detyrat e administratorëve të njëjësive administrative dhe të punonjësve të tjerë të këtyre njëjësive. Këto mangësi kanë bërë që sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të jetë jo i plotë.

Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër në mbështetje të kërkesave të nenit 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të hartohet dhe miratohet rregullorja e re e funksionimit të institucionit në të cilën të përshkruhen me hollësi detyrat dhe përgjegjësitë për secilin punonjës sipas strukturës së re, si dhe frekuenca e raportimit të Titullari nga secili menaxher.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga Titullari i institucionit nuk janë implementuar siç duhet kërkesat e ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ngritja e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe monitorimi i tij nuk ka qënë i plot, pasi nuk është ngritur grup pune për menaxhimin dhe marrjen në analizë të risqeve që rrëzikojnë objektivat e institucionit, nuk është hartuar regjistër risku nga asnjë nivel menaxheria dhe nuk është përgatitur gjurma e auditit për operacionet më të rëndësishme që kryen në institucion. Institucioni nuk ka të parashikuara rregulla për garantimin e ruajtjes së aktiveve të njëjësive, dokumentacionit dhe informacionit elektronik. Nuk është kryer nga Titullari analiza të sistemit të kontrollit të brendshëm për asnjë vit. Kjo ka sjell mungesë marrje përgjegjësie, mungesë monitorimi të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe mosmarrje të masave për minimizimin e risqeve.

Rekomandim: Nga Titullari i institucionit të përmirësohet sistemi kontrollit të brendshëm dhe monitorimi i tij, duke përcaktuar rregulla dhe procedura të qarta për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve të njëjësive, të dokumentacionit dhe të informacionit elektronik, të

hartohet regjistri i riskut nga secili nivel kryesor menaxherial. Për operacionet më të rëndësishme që kryen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatua se nuk janë përgatitur dokumentet e dosjes së auditimit. Çdo auditim përfaqsohet si i kryer me një material të shkurtër të emërtuar herë si akt konstatimi herë si raport dhe nuk ka dokument tjetër për procesin e auditimit, duke mos u respektuar standardet e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Plani auditimeve nuk është realizuar për asnjë vit të periudhës së audituar.

Nuk janë kryer auditime në fushat me risk, si sistemi i kontabilitetit, i prokurimeve, i pagesave, i të ardhurave, sistemi i menaxhimit të riskut, procesi i rekrutimit të stafit etj., të cilat duhet të përbënin drejtimet kryesore të auditit të brendshëm. Çdo plan afatgjatë dhe vjetor është formal dhe i pa zbatuar. Nuk është vlerësuar sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe nuk i janë sugjeruar Titullarit këshilla për përmirësimin e këtij sistemi, nuk janë konstatuar gjetje, duke mos u ndihmuar njësisia publike për arritjen e objektivave.

Të gjitha veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1, 2, 4, 5, 7 të nenit 21, “Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm”, të ligjit nr. 9720, datë 23. 04. 2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ku thuhet se audituesit e brendshëm duhet “të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ... me profesionalizëm dhe në përputhje me... procedurat e veçanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, ... të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me planin vjetor,... t’i japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive... për masat që duhen ndërmarë në rastet e konstatimit të dëmeve, ekonomike dhe financiare“, në kundërshtim me pikën 2, 3, 4, 5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 12, datë 5.6.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Rekomandim: Bashkia Mallakastër të marrë masa për organizimin shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditin e brendshëm publik” neni 10-Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016” Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik” Nga zyra e auditit të brendshëm të hartohen plane afatgjatë dhe vjetorë në fushat me risk të institucionit dhe të realizohen të gjitha planet e hartuara. Gjatë kryerjes së veprimtarisë konkrete të çdo auditimi të ndiqen të gjitha procedurat dhe hallkat e duhura të përcaktuara në manualet dhe udhëzimet e posaçme për këtë qëllim. Për çdo auditim ti bëhen prezent Titullarit mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe propozime për përmirësimin e tij.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në periudhën tre vjeçare, 2013-2015, objekt auditimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit është kryer tej afateve ligjore të përcaktuara me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në kërkesat e nenit 19, pika 4 dhe 5 “Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenin 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Bashkia Mallakastër të marrë të gjitha masat për hartimin në kohë, sa më real dhe objektiv të projekt buxhetit vendor dhe miratimin e tij në Këshillin e Bashkisë brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në hartimin dhe miratimin e buxhetit nuk janë përlllogaritur detyrimet afatshkurtra të Bashkisë ndaj të tretëve për 454 subjekte kreditore në vlerën 69,197 mijë lekë dhe detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë për 318 subjekte debitore në vlerën 751,868 mijë lekë, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Mallakastër të marrë të gjitha masat për reflektimin në hartimin dhe miratimin e buxhetit të çdo viti të detyrimeve afatshkurtra të Bashkisë ndaj të tretëve, si dhe detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë.

Me hartimin e buxhetit

8. Gjetje nga auditimi: Në nëntë raste janë marrë në punë me urdhër të brendshëm të ish Kryetarit të Bashkisë, punonjës, pozicioni i punës së të cilëve ka statusin e nëpunësit civil, pa u zbatuar procedurat e rekrutimit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, nenit 20, 21, 22 dhe 23 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Në këto raste janë burimet njerëzore që zbatojnë kërkesat e ligjit të mësipërm për rekrutimin e punonjësve, por edhe nga kjo njësi nuk ka asnjë procedurë shkresore të përgatitur për këtë qëllim. Kjo ka sjellë si pasojë pamundësinë e përfitimit të statusin të nëpunësit civil nga punonjësit.

Në një rast për marrjen në punë të shefit të policisë bashkiake nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 11 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”, të urdhrimit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit Publik, “Për miratimin e rregullores së brendshme “Tip” të policisë bashkiake dhe të komunës”, pasi nuk është ngritur asnjë komision për përzgjedhjen e kandidatëve për përgjegjësin e policisë bashkiake. Punonjësi është marrë në punë me urdhër të brendshëm të Titullarit në kundërshtim me kërkesat e mësipërme.

Rekomandim: Për plotësimin me punonjës të pozicioneve të punës që mbulohen nga statusi i nëpunësit civil, dhe marrjen në punë të punonjësve të policisë Bashkiake, nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë, të zbatohen të gjitha procedurat e rekrutimit sipas kërkesave të ligjeve përkatëse në fuqi.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Bilanci kontabël i vitit 2013 paraqet pasaktësi pasi nuk është i kuadruar në vlerën 2,547,834 lekë, diferencë e konstatuar në Klasa 4 “Detyrime” dhe konkretisht në llogarinë sintetike nr.466 “Kreditor për mjete në ruajtje” e sistemuar nga jashtë në bilancin e vitit 2014.

-Në bilancet vjetore nga Drejtoria e Financës, debitorët për detyrimet e ndryshme, janë pasqyruar padrejtësisht në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” kur duhej pasqyruar në llogarinë nr.468 “Debitor të ndryshëm”, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të bëjë sistemimin kontabël të bilancit mbi debitorët për detyrimet e ndryshme, të cilët janë pasqyruar padrejtësisht në llogarinë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm” kur duhej pasqyruar në llogarinë nr.468 “Debitor të ndryshëm”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Mjetet themelore, ndërtesat, janë regjistruar në kontabilitet me vlerë fillestare të tyre me çmimet e vjetra pa u bërë rivlerësimi i tyre, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe objektet e ndërtesave nuk janë regjistruar në ZVRPP.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të ngrejë komisionin e rivlerësimit të mjeteve themelore dhe të bëjë sistemimin kontabël për rritjen e vlerës së tyre dhe të insistojë vazhdimisht për rregjistrimin e tyre në ZVRPP.

Brenda datës 31.12.2016

11. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për gjoba të aplikuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve në katër raste në vlerën **237,758 lekë** për derdhje me vonesë të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9146, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar dhe nenin 33, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Rekomandim: Për pagesat e detyrimeve të kryera me vonesë në vlerën **237,758 lekë**, si më sipër, Këshilli i Bashkisë Mallakastër të analizojë veprimet e kryera, arsyet dhe argumentet justifikuese dhe të nxjerrë përgjegjësinë.

Brenda datës 31.07.2016

12. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014 nëpërmes Zyrës Përmbartimore janë paguar detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, për largime të pamotivuara nga puna para vitit 2013 të 11 (njëmbëdhjetë) ish punonjësve në vlerën **3,618,600 lekë gjithsej**, nga të cilat për 10 (dhjetë) raste në vlerën **740,000 lekë** dhe për vitin 2015 për 11 (njëmbëdhjetë) ish punonjës në vlerën **2,878,600 lekë** të larguar padrejtësisht nga puna para vitit 2013 të cilat kanë shkaktuar impakt negativ në shpenzimet e planifikuara për paga të punonjësve.

Rekomandim: Për pagesat e kryera nëpërmes Zyrës Përmbartimore për detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, për largime të pamotivuara nga puna para vitit 2013 të 11 (njëmbëdhjetë) ish punonjësve në vlerën **3,618,600 lekë gjithsej**, nga të cilat për 10 (dhjetë) raste në vlerën **740,000 lekë** dhe për vitin 2015 për 11 (njëmbëdhjetë) ish punonjës në vlerën **2,878,600 lekë** të larguar padrejtësisht nga puna para vitit 2013, si më sipër, Këshilli i Bashkisë Mallakastër të analizojë veprimet e kryera dhe nxjerrë përgjegjësinë.

Brenda datës 31.07.2016

13. Gjetje nga auditimi: Në dokumentacionin bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla mungonte kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

Rekomandim: Në të gjitha rastet e shpenzimeve me bankë për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla të administrohet më parë kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar kryerje pagesash për blerje në vlera të vogla apo kryerje shërbimesh dhe aktivitete të ndryshme me tejkalim limitesh mbi vlerat e lejuara në vit për një artikull ose grup artikujsh, raste të diferencave të çmimeve.

Rekomandim: Në asnjë rast të mos lejohet tejkalimi i limitit të lejuar për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për vitin **2015** inventarizimi fizik i vlerave materiale nuk është realizuar fare, veprim në kundërshtim me Kreun II “*Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve*” neni 6 “*Evidenca mbështetëse*” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “*Inventari i aktiveve dhe detyrimeve*” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar dhe Kreun IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pikën 73 dhe 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve një njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë të gjitha masat për kryerjen e inventarizimit fizik të vlera materiale dhe rakordimin e tyre me kontabilitetin.

Brenda 30.06.2016

16. Gjetje nga auditimi: Sipas **aktkonstatimit datë 10.09.2014** mbajtur nga Sektori i Auditit të Brendshëm i Prefekturës së Qarkut Fier mbi auditimin tematik për inventarizimin e vlerave materiale në 8 (tetë) shkollat e ish Komunave Mallakastër kanë rezultuar diferenca në mungesa në vlerën **729,867 lekë** gjithsej të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet si detyrime dhe nuk është ndjekur arkëtimi i tyre të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprim në kundërshtim me Kreun II “*Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve*” neni 6 “*Evidenca mbështetëse*” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “*Inventari i aktiveve dhe detyrimeve*” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar.

Rekomandim: Titullari i Bashkisë, Drejtoria e Financës të analizojë në Këshillin Bashkiak veprimet e kryera për inventarizimin e vlerave materiale në 8 (tetë) shkollat e ish Komunave Mallakastër ku kanë rezultuar diferenca në mungesa në vlerën **729,867 lekë** gjithsej të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet si detyrime dhe të nxjerrin përgjegjësinë.

Brenda datës 31.07.2016

17. Gjetje nga auditimi: Për vitin **2013** kanë rezultuar diferenca në mungesa gjithsej në vlerën **1,297,551 lekë** nga e cila në llogarinë 327 “*objekte inventari*” në vlerën 738,764 lekë, për llogari të shkollës së mesme dhe në llogarinë 218 “*inventar ekonomik*” në vlerën 558,787 lekë, nga e cila për llogari të shkollës së mesme në vlerën 514,447 lekë dhe shkollës 9 vjeçare “5 Shkurti” në vlerën 44,340 lekë.

Megjithëse për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale nga vjedhja dhe dëmtimet si më sipër, titullari i Bashkisë me datë 25.07.2013 ka ngarkuar Përgjegjësin e Policisë Bashkiake dhe Përgjegjësin e Shërbimeve Publike për të bërë edhe kallëzim në organet kompetente, vlerat materiale kanë kaluar në rezultat, veprim në kundërshtim me Kreun II “*Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve*” neni 6 “*Evidenca mbështetëse*” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “*Inventari i aktiveve dhe detyrimeve*” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar.

Rekomandim: Titullari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës bazuar në kreun IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” pika 95 deri 101 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve një njësitë e sektorit publik” të analizojë në

Këshillin Bashkiak veprimet e kryera në inventarizimin e vlera materiale për vitin **2013 ku** kanë rezultuar diferenca në mungesa gjithsej në vlerën **1,297,551 lekë** nga e cila në llogarinë 327 “objekte inventari” në vlerën 738,764 lekë, për llogari të shkollës së mesme dhe në llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerën 558,787 lekë, nga e cila për llogari të shkollës së mesme në vlerën 514,447 lekë dhe shkollës 9 vjeçare “5 Shkurti” në vlerën 44,340 lekë dhe të nxjerrë përgjegjësinë.

Brenda datës 31.07.2016

18. Gjetje nga auditimi: Për vitin **2015** me urdhër shpenzimet nr.442 dhe nr.443 datë 25.11.2015 janë blerë pjesë këmbimi për automjete në vlerën 650,000 lekë gjithsej dhe pas zëvendësimit të tyre, ato nuk janë dokumentuar në magazinë si pjesë këmbimi rikupero.

Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve të verifikojë gjendjen e pjesëve të këmbimit të vjetra që ndodhen para Bashkisë dhe të bëjë dokumentimin dhe ruajtjen në magazinë të pjesëve të këmbimit të vjetra rikupero ose në të kundërt të kërkoet zhdëmtimi i vlerës së tyre nga personat përgjegjës.

Brenda datës 30.06.2016

19. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i financës nuk janë pasqyruar në kontabilitet dhe për rrjedhojë nuk është ndjekur arkëtimi i detyrimeve të prapambetura nga viti 2013 për taksat dhe tarifatat vendore nga 318 subjekte në vlerën 751,868 mijë lekë, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin për taksat dhe tarifatat vendore për 318 subjekte në vlerën 751,868 mijë lekë dhe të kërkojë çdëmtimin nga personat përgjegjës.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga mosarkëtimi i të ardhurave të trashëguara përpara vitit 2013 dhe për peridhën e audituar (2013, 2014 dhe 2015), janë krijuar debitorë në vlerë totale prej 751,868 mijë lekë, Vlera e mësipërme është e ardhur e munguar për Bashkinë Mallakastër dhe në të përfshihen edhe vlerat e paarkëtuara të taksave dhe tarifave të ish komunave, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Rekomandim: Për arkëtimin e detyrimeve tatimore **751,868 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **të nxiren njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar, me ligjin

nr.164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d-Në rast se bizneset private edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashki, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

Brenda datës 30.06.2016

21. Gjetje nga auditimi: Largimet nga puna të punonjësve dhe lëvizja e tyre paralele, është bërë pa u dorëzuar më parë detyra prej tyre me procesverbal, duke bërë që të mos dorëzohet sipas rregullave dokumentacioni dhe aktivet nga njeri punonjës te tjetri. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 13 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pikën 50 të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”.

Rekomandim: Sektori burimeve njerëzore të marrë masa që në të gjitha rastet, përpara largimit apo lëvizjes së brendëshme të punonjësit, të bëhet nga ana e tij dorëzimi me procesverbal i detyrës, duke përfshirë dorëzimin e dokumentacionit shkresor, elektronik, dhe të gjitha aktivet që ka në ngarkim.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i akteve të kontrollit të inspektorëve të zyrës së taksave dhe tarifave vendore konstatohet se në vitin 2013 janë ushtruar gjithsej 60 kontrolle në subjekte private, për të cilat nuk është trajtuar asnjë problematikë. Në vitin 2014 janë ushtruar 77 kontrolle dhe në vitin 2015 janë ushtruar 33 kontrolle në subjekte private të cilët janë konstatuar pa u regjistruar në QKR dhe, nga zyra e taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë masa për mbyllje të veprimtarisë dhe konfiskim të materialeve, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Rekomandim: Gjatë kryerjes së kontrolleve në terren në subjekte private nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore, të jenë objekt kontrolli elementët specifik të biznesit, si rregullshmëria e përdorimit të kasës fiskale, lëshimi i kuponit tatimore, regjistrimi i të dhënave në librin e xhiros, regjistrimi i blerjeve të realizuara për qëllime biznesi (rishitje, përpunim etj.), matja e xhiros me qëllim vlerësimin e qarkullimit të deklaruar nga tatimpaguesi etj. Në rastet e konstatimeve të subjekteve pa NIPT të bëhet mbyllja e aktivitetit dhe konfiskimi i mallit sipas procedurave ligjore në fuqi. Bashkia Mallakastër të marrë masa që aktet e kontrollit, të konstatimit, të gjobave, etj., që do të përdoren nga inspektorët të jenë të pajisur me numra serial dhe të trajtohen si letra me vlerë.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka miratuar leje zhvillimore infrastrukture nr. 1, datë 19.02.2015, për punimet: “*Sistemim i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit*”, në kushtet kur nuk është kërkuar dhe nuk është marrë kontrolli i përputhshmërisë të lejes zhvillimore nga AKPT, për të cilën nuk është njoftuar dhe KKT, veprime këto në kundërshtim me pikën

2 të Vendimit nr. 8, datë 07.11.2014 të KKT, “Për miratimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi”.

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në miratimin e lejeve zhvillimore, të kërkojë dhe të marrë kontrollin e përputhshmërisë të lejes zhvillimore nga Agjensia e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për të cilën të njoftojë dhe Këshilli Kombëtar i Territorit.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Me vendimin e KRRT-së nr. 4 datë 07.11.2008 është miratuar leja e zhvillimit për subjektin ndërtues “A...” për objektin lokal + banesë, në dosje mungon çertifikata e pronësisë, kontrata që duhet të ishte lidhur me pronarin e truallit, ose personin i cili ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja, veprime këto në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 2 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të plotësojë dosjen e lejes së përdorimit, ku të administrohet çertifikata e pronësisë, kontrata e lidhur me pronarin e truallit, ose personin i cili ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Mallakastër, në 6 raste vendime pezullimi, për kryerje punime pa leje ndërtimit, nuk ka aplikuar gjobë, në shumën 300.000 lekë secili, në total 1.800.000 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar, veprime këto në kundërshtim me seksionin VII neni 82, pika 8 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në të gjitha rastet e vendimeve të pezullimit për ndërtimet pa leje, pas afatit 10 ditor të aplikojë gjobë në vlerën 300,000 lekë, deri në 30 për qind të vlerës totale të punimeve të kryera pa leje.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Mallakastër, në 2 vendime prishje, për kryerje punime pa leje ndërtimit edhe pas afatit 10 ditor, nuk ka aplikuar gjobë, në shumën 500.000 lekë secili, në total 1.000.000 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar veprime këto në kundërshtim me:

- pikën 8 të Vendim nr.862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor i ndryshuar me: Vendim nr. 625, date 28.7.2010,

- pikën 8 të Vendimit nr. 846, datë 27.10.2010, në kundërshtim me neni 52 shkronja (e) ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Rekomandim: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, në të gjitha rastet e vendimeve të prishjes për ndërtimet pa leje, pas afatit 10 ditor të aplikojë gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Mallakastër, nuk ka bashkëvepruar dhe bashkërenduar veprimet inspektuese ndërmjet policisë Bashkiake dhe me autoritetet e planifikimit, kur në dijeni të fakteve, autoritet i inspektimit nuk rezulton të ketë njoftuar autoritetin tjetër përgjegjës, pasi: Për ndërtimet/ shtesat e kundërligjshme të cilat janë evidentuar nga verifikimi në terren të bërë të pronave publike në pronësi/ përdorim të Bashkisë Mallakastër, si dhe nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime kryesisht,

si vendosja e gjobave sipas llojit të shkeljeve në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, veprime këto në kundërshtim me:

- seksionin VII, neni 81 pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar,

-nenin 5, pika d, dh, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin e ndërtimit”.

-pikat b, ii), iii) të Vendimit KM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”.

Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, në bashkëpunim me policinë e Bashkisë dhe me drejtorinë e planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit, të kryej kontrollin në terren, të pronave publike në pronësi/ përdorim të Bashkisë Mallakastër, të cilat rezultojnë të jenë zënë nga ndërtimet dhe shtesa të kundërligjshme, të bëhet lirimi i tyre, prishja e objekteve të kundërligjshme dhe ndaj kundërvajtësve të aplikohen masat administrative dënime me gjobë si dhe të përgatitet kallëzimi penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit.

Brenda datës 30.06.2016

28. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Titullari të Bashkisë Mallakastër, nuk është kryer miratimi i rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, si rezultat trojet, ndërtesat objektet në pronësi/ përdorim apo administrim të Bashkisë Mallakastër, të pretenduar për pronësi nga të tretë por të pa regjistruara në ZVRPP Mallakastër, rezultojnë të zaptuara, jashtë funksioni të pa vëna në efikasitet, ose të përdorura në mënyrë të paligjshme duke ndërtuar në to apo rrethuar pa drejtësisht nga persona të pa autorizuar veprime këto në kundërshtim, me kreun II, neni 8 pika 8 shkronja ç, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me kreun (I), pika 5, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Rekomandim: Titullari i njësisë publike të kryej miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike duke evidentuar të gjitha objektet apo pronat e zaptuara, jashtë funksionit, të pa vëna në efikasitet, ose të përdorura në mënyrë të paligjshme nga persona të pa autorizuar.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mallakastër në 3 raste, ka dhënë me qira objekte me sipërfaqe totale 113.30 m², të cilat nuk janë në pronësi të Bashkisë Mallakastër dhe nuk posedohet çertifikata pronësie, veprime këto në kundërshtim me nenin 678, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shkronjën c, neni 116, të ligj nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe shkronja e, pika 1, kreu II, të Vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Rekomandim: Bashkia Mallakastër të marrë masa, që dhënien me qira të objekteve ta bëjë pas regjistrimit të pasurive në ZVRPP Mallakastër, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore zgjidhjen e kontratave objekti i të cilave nuk është i mundshëm dhe i ligjshëm.

Menjëherë

30. Gjetje nga auditimi: Njësitë Administrative ish-Komunat: Aranitas, Selitë, Fratar, Qendër, Hekal, Kutë dhe Bashkia Ballsh në 179 raste kanë dhënë me qira toka bujqësore,

livadhe dhe ullishte në sipërfaqen 808 ha gjithsej, pa i regjistruar më parë në ZVRPP, për të cilat nuk posedohet certifikata pronësie, kontrata qiraje të cilat nuk janë bërë me akt noterial dhe të pa regjistruara në regjistrin publik, veprime këto në kundërshtim me nenin 678, shkronja a, neni 826 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shkronjën c, neni 116, të ligj nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” pasi:

a) Për ish-Komunat, Aranitas, Selitë, Fratar, Qendër, Hekal, Kutë, procesi i kalimit të pronave në pronësi të komunës ende nuk ka përfunduar, duke mos zbatuar VKM nr. 500, datë 14.08.2001 i ndryshuar me VKM nr.1277, datë 23.12.2009, për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

b) Dhënia me qira e tokave bujqësore është kryer pa i pasur ato në pronësi, duke vepruar në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

c) Kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara të ish komunave Aranitas, në 38 raste për sipërfaqen 51,99 ha, Selitë në 5 raste për sipërfaqen 6,6 ha, Fratar në 15 raste për sipërfaqen 17,59 ha, Qendër në 69 raste për sipërfaqen 632,4 ha, Hekal në 28 raste për sipërfaqen 74,428 ha dhe Kutë në 24 raste për sipërfaqen 25 ha, janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë në kundërshtim edhe me sa përcakton neni 678 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe neni 32 i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

d) Nga 179 kontrata të lidhura për dhënien me qira të tokave të pandara, me sipërfaqe prej **808 ha**, kontratat e lidhura me qeramarësit **nuk janë TIP** (sipas formatit ligjor) dhe në to nuk janë vendosur sanksione, për të cilat nuk mund të llogariten kamat vonesa. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 234, datë 09.07.2007 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së "Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore" dhe të "Formularit Tip" të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore" dhe me udhëzimin e KM nr. 3, datë 16.05.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", ndryshuar me udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara". Listat e kontratave për të cilët kërkohet deklarimi si të pavlefshme paraqiten në faqen nr 5,6,7 dhe 8 të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Rekomandim: Bashkia Mallakastër, të marrë masa dhe të kryejë të gjitha procedurat administrativo ligjore bazuar në nenet 115, 116/c, 117 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Për Kodin e Procedurës Administrative” për deklarimin e pavlefshëm të tre kontratave të objekteve me sipërfaqe 113,3 m2 dhe të 179 kontratave të qirasë së tokave të pandara me sipërfaqe 808 ha gjithsej.

Menjëherë

31. Gjetje nga auditimi: Nga ana e strukturave të Policisë Bashkiake, nuk janë realizuar detyrat funksionale si: të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të Bashkisë si dhe të organizojë lirimimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me nenin 8, pika 6 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkise dhe te komunës”.

Rekomandim: Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të kryej kontrollin në terren, të pronave publike në pronësi/ përdorim të Bashkisë Mallakastër, të

cilat rezultojnë të jenë zënë nga ndërtimet dhe shtesa të kundërligjshme, të bëhet lirimi i tyre, prishja e objekteve të kundërligjshme dhe ndaj kundërvajtësve të aplikohen masat administrative dënime me gjobë si dhe të përgatitet kallëzimi penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit.

Brenda datës 31.07.2016

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në pikën 5 neni 13, pika 14 neni 43, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 48,730,994 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në tre tendera rezultojnë shkelje në zhvillimin e procedurave të shoqëruara me dëm ekonomik gjithsej në vlerën **44,293,420 lekë**.

a. Në tre tendera janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore në hartimin e dokumenteve të tenderit, vlerësimin e ofertave, kualifikimin dhe skualifikimin e tyre dhe shpalljen e fituesit me efekt ekonomik në vlerën **44,293,420 lekë** i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe konkretisht:

1. Në dokumentacionin e tenderit me objekt “*Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit*” në vlerën **12,691,141 lekë** për vitin 2014 me fond limit në vlerën 42,446,733 lekë pa TVSH.

2. Në dokumentacionin e tenderit me objekt “*Ndërtim i rrjetit shpërndarës i fshatrave të Komunës Fratar*” në vlerën **29,564,908 lekë** pa TVSH për vitin 2015 me fond limit në vlerën 67,445,125 lekë pa TVSH.

3. Në dokumentacionin e tenderit me objekt “*Ndërtim kopështi 1 kat Komuna Fratar Mallakastër*” në vlerën **2,037,371 lekë** pa TVSH për vitin 2014 me fond limit në vlerën 7,308,984 lekë pa TVSH. (*Trajtuar në faqet 75-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë si detyrim vlerën **44,293,420 lekë** si diferencë e ofertës fituese me ofertën e skualifikuar dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **44, lekë** nga Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe operatori ekonomik përfitues si vijon:

1. Në dokumentacionin e tenderit me objekt “*Sistemimi i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit*” në vlerën **12,691,141 lekë** pa TVSH sipas kontratës nr.803 datë 04.08.2014 nga e cila:

- **R.Sh.** me detyrë zv/kryetar i Bashkisë Ballsh në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 1,586,393 lekë,

- **J.A.** me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 1,586,393 lekë,
- **E.N.** me detyrë specialiste në zyrën e urbanistikës në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 1,586,393 lekë,
- **E.I.** me detyrë spacialist në zyrën e Financës në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 1,586,393 lekë,
- **J.M.** me detyrë specialist në zyrën e taksave vendore në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 1,586,393 lekë,
- N.M.** me detyrë përgjegjës i taksave vendore, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në vlerën 1,586,393 lekë,
- E.J.** me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në vlerën 1,586,393 lekë,
- B.F.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në vlerën 1,586,393 lekë.

2. Në objektin “*Ndërtim i rrjetit shpërndarës i fshatrave të Komunës Fratar*” në vlerën **29,564,908 lekë** pa TVSH sipas kontratës datë për vitin 2015 nga e cila:

- B.T.** me detyrë inspektor urbanistike në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit në vlerën 4,927,485 lekë,
- S.M.** me detyrë jurist në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në vlerën 4,927,485 lekë,
- A.S.** me detyrë përgjegjës i taksave vendore në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 4,927,485 lekë
- K.A.** me detyrë zv/kryetar në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 4,927,485 lekë,
- S.D.** me detyrë përgjegjës i financës në cilësinë anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 4,927,485 lekë
- H.M.** me detyrë arkiviste në cilësinë në vlerën 4,927,485 lekë.

3. Në objektin “*Ndërtim kopështi I kat Komuna Fratar Mallakastër*” sipas kontratës datë në vlerën **2,037,371 lekë** pa TVSH për vitin 2014 nga e cila:

- **B.T.** me detyrë specialist urbanistike në cilësinë e anëtarit të Njësia e Prokurimit në vlerën 339,562 lekë,
- **H.M.** me detyrë arkiviste në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 339,562 lekë,
- **A.S.** me detyrë përgjegjës i taksave vendore në cilësinë anëtarit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në vlerën 339,562 lekë
- **S.D.** me detyrë përgjegjës i financës në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në vlerën 339,562 lekë,
- **Sh.Rr.** me detyrë inspektor i ndihmës ekonomike në cilësinë e antarit të KVO në vlerën 339,562 lekë
- **N.M.** detyrë inspektor i taksave vendore në cilësinë e antarit të KVO në në vlerën 339,562 lekë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në 12 raste janë kryer pagesa për shpenzime operative në blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla pa dokumente argumentuese dhe justifikues në vlerën **1,122,682 lekë** si vijon:

- Nga analiza e çmimeve të blerjes së dy artikujve ushqimor rezulton se janë prokuruar me çmime më të larta se çmimi mesatar i tregut. Diferenca e çmimit të prokuruar me çmimin mesatar për të dy artikujt e lartpërmendur është në vlerën **39,007 lekë** dhe përbën përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesit operatori ekonomik R.M. në vlerën 27,214 lekë dhe operatori ekonomik F.Ç. në vlerën 11,793 lekë për të cilën mban përgjegjësi komisioni i blerjeve me vlera të vogla z.J.M, M.Ll, E.J. dhe V.M.

-Me urdhër shpenzimin nr. 26, datë 21.02.2013 në vlerën **399,600 lekë** është kryer pagesë për blerje lodrash për Vitin e Ri për llogari të subjektit fizik E.L.

- Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 02.05.2013 në vlerën 132,840 lekë për llogari të subjektit “E...” është kryer pagesë për blerje gazoil sipas urdhër prokurimit nr.21.1 datë 01.02.2012 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit datë 27.02.2012 të komisionit të blerjes, ku nuk ka nënshkruar E.J., faturës nr. 80, datë 27.02.2012 në sasinë 120 litra, urdhër prokurimit nr.40 datë 02.04.2012 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit datë 30.04.2012 të komisionit të blerjes, ku nuk ka nënshkruar E.J, faturës nr. 163, datë 27.04.2012 në sasinë 600 litra. Dokumentimi në magazinë është bërë me fletë hyrjen nr.4 datë 30.04.2012 në sasinë 600 litra ose me diferencë më pak pa bërë hyrje në sasinë 120 litra gazoil në vlerën **21,840 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

- Me urdhër shpenzimin nr. 114, datë 11.09.2013 në vlerën 132,000 lekë, për llogari të subjektit “Sh...”, janë kryer shpenzime transporti Ballsh-Tiranë, Ballsh-Përmet. Pagesa Ballsh-Përmet për 63 persona x 1,140 lekë/personi = 71,820 lekë ndërkohë që duhej paguar 1,000 lekë për person d.m.th paguar më tepër në vlerën **8,820 lekë**.

- Sipas urdhër shpenzimit nr.162, datë 02.07.2015 në vlerën **247,680 lekë** është kryer pagesë për llogari të subjektit Sh..., për shpenzime transporti për kutitë e votimit, urdhër prokurimi nr.3 datë 30.06.2015 me fond limit 247,689 lekë, ose 9 ditë pasi kishin përfunduar zgjedhjet, procesverbali i emergjencës datë 29.06.2015, ose një ditë para daljes së urdhër prokurimit.

- Sipas urdhër shpenzimit nr.445, datë 25.11.2015 në vlerën **48,000 lekë** është kryer pagesë për llogari të subjektit D.Gj, për blerje lule, urdhër prokurimi nr.21 datë 31.01.2013, procesverbali datë 20.09.2013, fatura nr.141 datë 20.09.2013, fletëhyrja nr.31 datë 07.10.2013 ose 18 ditë pas faturës së shitësit për 15 copë lule me çmimin 3,200 lekë, pa përcaktuar nevojën e blerjes dhe përdorimin e tyre,

- Sipas urdhër shpenzimit nr.351, datë 23.11.2015 për vlerën 384,000 lekë është kryer pagesë për llogari të subjektit M.B, për blerje kancelerie, duke zbatuar procedurën e prokurimeve publike, urdhër prokurimi nr.6 datë 03.09.2015, kontrata datë 07.09.2015, fatura nr. 574 datë 10.09.2015, fletë hyrja nr.370 datë 07.09.2015. Zbatimi i kontratës është realizuar me operatorin ekonomik Magri bana i renditur i treti në klasifikim, pasi i pari është klasifikuar E... me vlerën 141,720 lekë dhe i dyti është klasifikuar I... me vlerën 291,600 lekë ose me diferencën më shumë nga oferta e parë në vlerën **93,936 lekë**. Për tërheqjen e dy subjekteve të klasifikuara në vendin e parë dhe të dytë nuk administrohet procesverbali i komisionit të blerjeve me vlera të vogla, veprim i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik,

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 588, datë 21.12.2015 në vlerën **56,200 lekë** është kryer pagesë për llogari të subjektit H.Sh për blerje kancelerie, sipas prokurës së posaçme nr.849 rep.

nr.317 kol. datë 17.12.2015, të M.S. për H.SH, ose tre vjet e 10 muaj pas blerjes së mallrave, urdhër prokurimit nr.13 datë 18.02.2012 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit të blerjes datë 21.02.2012, faturës nr. 2 datë 21.02.2012, fletë hyrja nr.9 datë 21.02.2012, veprim i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi H.SH.

-Sipas urdhër shpenzimit nr. 589, datë 21.12.2015 në vlerën **9,000 lekë** është kryer pagesë për llogari të subjektit H.SH. për blerje kancelerie, sipas prokurës së posaçme nr.849 rep. nr.317 kol. datë 17.12.2015, të H.SH. për H.SH. ose 4 vjet e 7 muaj pas blerjes së mallrave, urdhër prokurimit nr.49 datë 04.05.2011 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit të blerjes datë 04.05.2011, faturës nr. datë 06.05.2011, fletë hyrja nr.22 datë 06.05.2011 veprim i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi H.SH.

-Sipas urdhër shpenzimit nr. 590, datë 21.12.2015 në vlerën **13,000 lekë** është kryer pagesë për llogari të subjektit H.SH. për blerje kancelerie, sipas prokurës së posaçme nr.849 rep. nr.317 kol. datë 17.12.2015, të M.S. për H.SH. ose tre vjet e 8 muaj pas blerjes së mallrave, urdhër prokurimit nr.38 datë 17.04.2012 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit të blerjes datë 18.04.2012, faturës nr. 16 datë 18.04.2012, fletë hyrja nr.2 datë 18.04.2012.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 605, datë 28.12.2015 në vlerën 437,799 lekë është kryer pagesë për llogari të subjektit L.SH. person fizik për rikonstruksion banesash dhe lyerje me bojë, për blerjen e 150 mst dru zjarri, sipas urdhër prokurimit nr.5.1 datë 12.11.2015 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit të vlerësimit datë 17.11.2015, ku është shpallur fitues P.SH. në vlerën 420,000 lekë, procesverbalit të blerjes datë 03.12.2015 në vlerën 437,799 lekë, ose **17,799 lekë** më shumë se vendi i parë, nuk është lidhur kontratë furnizimi, procesverbalet e dorëzimit në shkolla pa datë, faturës nr. 28 datë 15.12.2015, fletë hyrja nr.52 datë 15.12.2015. Në ftesën për ofertë datë 16.11.2015 nuk është kërkuar licensa profesionale e subjektit, leja për shfrytëzimin e lëndës drusore lëshuar nga Drejtoria e Pyjeve, nuk është përcaktuar afati i lëvrimit të druve të zjarrit.

- Sipas urdhër shpenzimit nr. 607, datë 28.12.2015 në vlerën 417,800 lekë është kryer pagesë për llogari të subjektit L.SH. person fizik për rikonstruksion banesash dhe lyerje me bojë, për blerjen materiale zbukurimi për festat, sipas urdhër prokurimit nr.15 datë 10.12.2015 për blerje me vlera të vogla, procesverbalit të vlerësimit datë 15.12.2015,ku është shpallur fitues M... në vlerën 250,000 lekë, procesverbalit të blerjes datë 16.12.2015 në vlerën 417,800 lekë, ose **167,800 lekë** më shumë se vendi i parë, nuk është lidhur kontratë furnizimi, fatura nr. 33 datë 18.12.2015, fletë hyrja nr.53 datë 18.12.2015.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr.2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr.3 datë 27.01.2015, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar, nenin 35 germa a, nenin 38 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë dhe të kërkoj në të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e detyrimit për pagesat e kryera në shpenzimet operative pa dokumentacionin e nevojshëm ligjor argumentues dhe justifikues në vlerën **1,122,682 lekë** lekë dhe të kërkojë arkëtimin nga personat përgjegjës dhe subjektet përfituese si vijon:

1. Subjeti fizik, R.M. në vlerën **27,214 lekë** për diferencë çmimi në dy artikuj ushqimor.

2. Subjeti fizik, F.C. në vlerën **11,793 lekë** për diferencë çmimi në dy artikuj ushqimor.
3. Komisioni i shpërndarjes së lodrave të vitit të ri në vlerën **399,600 lekë** gjithsej, nga të cilat: Xh.Y. me detyrë, ish drejtores e financës në cilësinë e kryetarit të KBV në vlerën 133,200 lekë, Sh.M. specialiste e financës në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 133,200 lekë dhe H.A. specialiste e ndihmave ekonomike në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 133,200 lekë.
4. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla për karburant të blerë dhe të likuiduar pa dokumentuar në magazinë në sasinë 120 litra gazoil në vlerën **21,840 lekë**, nga të cilat: Xh.Y. me detyrë, ish drejtores e financës në cilësinë e kryetarit të KBV në vlerën 7,280 lekë, J.M. me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 7,280 lekë dhe M.Ll. me detyrë specialist i sektorit të taksave në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 7,280 lekë.
5. Subjekti i transportit “Sh...” në vlerën **256,500 lekë** gjithsej për shërbim transporti në dy raste në vlerën 8,820 lekë dhe 247,680 lekë.
6. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në vlerën **141,936 lekë** gjithsej për dy raste në vlerën 48,000 lekë për blerje lule dhe 93,936 lekë për blerje kancelarie, nga të cilat: Jonida Aliaj me detyrë, ish drejtores e financës në cilësinë e kryetarit të KBV në vlerën 47,312 lekë, J.M. me detyrë përgjegjës i sektorit të taksave në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 47,312 lekë dhe V.M. me detyrë specialist i sektorit të taksave në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 47,312 lekë.
7. Subjekti fizik “H.Sh.” në vlerën **78,200 lekë** për blerje kancelarie.
8. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në vlerën **185,599 lekë** gjithsej për dy raste në vlerën 17,799 lekë dhe 167,800 lekë për diferenca të ofertave nga skualifikimi i konkuresve, nga të cilat: A.R. me detyrë drejtor ekonomik në cilësinë e kryetarit të KBV në vlerën 61,867 lekë, N.K. me detyrë përgjegjës i sektorit të burimeve njerëzore në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 61,867 lekë dhe E.H. me detyrë jurist në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 61,867 lekë.

Brenda datës 31.08.2016

3. Gjetje nga auditimi: Në dy raste në vlerën **380,800 lekë** janë kryer shpenzime për aktivitete kulturore kur në fakt këto shpenzime janë kryer për dreka, d.m.th. jashtë qëllimit të shpenzimit për të cilën është planifikuar e përshkruar në urdhër shpenzimi dhe dokumentacioni argumentues e justifikues i tyre paraqitet me mangësi në si vijon:

-Me urdhër shpenzimin nr. 85, datë 24.09.2014 në vlerën 79,800 lekë, është paguar subjekti “D...” Tiranë për shpenzime dreke me rastin e 72 vjetorit të Konferencës së Pezës, për të cilin mungon lista e personave pjesëmarrës, mungon procesverbali i komisionit të blerjeve në vlera të vogla për shpenzimin e kryer. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr.2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr.3 datë 27.01.2015, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar.

-Sipas faturave të palikujduara, procesverbalit datë 14.07.2012 janë kryer shpenzime për drekë në Poçëm, për llogari të personit fizik T.Y, për festën e 14 Korrikut në vlerën 301,000 lekë, për të cilin nuk ka listë të pjesëmarrësve, fatura është e pa firmosur nga dy antarët e komisionit të blerjeve në vlera të vogla. Veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, pasi bien në kundërshtim me VKM nr. 243, datë

15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999.

- pika 9, e VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar dhe pika 1/b, të VKM nr. 472, datë 2.07.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” dhe detyrim për arkëtim nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin e mësipërm dhe të kërkojë çdëmtimin e vlerës 380,800 lekë nga 6 (gjashtë) personat përgjegjës:

-Xh.Y, me detyrë ish drejtore e financës, në cilësinë e kryetares së KBV në vlerën 63,467 lekë,

-J.A, me detyrë ish drejtore e financës në cilësinë e antarës së KBV në vlerën 63,467 lekë,

-J.M. me detyrë inspektor dhe përgjegjës i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 63,467 lekë,

-M.Ll. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 63,467 lekë,

E.J. me detyrë jurist në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 63,467 lekë,

-V.M. me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore në cilësinë e antarit të KBV në vlerën 63,467 lekë.

Brenda datës 31.08.2016

4. Gjetje nga auditimi: Në katër raste janë kryer shpenzime operative të pa planifikuara, jashtë destinacionit dhe pa dokumente argumentuese e justifikuese në vlerën **272,600 lekë** gjithsej si vijon:

-Me fletë hyrjen nr.1 datë 4.01.2013 në vlerën **138,750 lekë** janë blerë lodra për vitin e ri nga subjekti fizik S.H, ndërkohë që lodrat janë përdorur në fund të vitit 2012. Shpenzimi i kryer në vlerën 138,750 lekë nuk ka dokumentacionin argumentues dhe justifikues prandaj është i pajustificuar dhe si i tillë nuk duhet të bëhet likuidimi mbasi është veprim fiktiv.

-Sipas procesverbalit datë 22.10.2010 të KVO dhe faturat e subjektit fizik z. F.A. janë kryer shpenzime në vlerën **100,000 lekë**, për aktivitet kulturor artistik (libret orkestrime, skenografi). Për këtë shpenzim nuk ka Vendim të Këshillit të Kulturës, nuk ka preventiv për të llogaritur punën e kryer, subjekti nuk ka licencë nga QKR për këtë lloj shpenzimi, etj. Shpenzimi i kryer në vlerën 100,000 lekë është i pajustificuar me dokumentacion dhe si i tillë nuk duhet të likuidohet.

Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr.2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr.3 datë 27.01.2015, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar.

-Në dy raste janë kryer shpenzime për transport veteranësh në vlerën **33,850 lekë** për llogari të subjektit Sh... për 14 persona. Pagesat e transportit janë kryer më shumë se tarifatat përkatëse pasi janë në kundërshtim me VKM nr.66, datë 7.02.2007 “Për disa ndryshime në VKM nr.146, datë 26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, (vlera 22,450 lekë +11,400 lekë) të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin e mësipërm dhe të kërkojë çdëmtimin e vlerës 272,600 lekë nga tre personat përfitues.

Brenda datës 31.07.2016

5. Gjetje nga auditimi: Në periudhën Korrik-Gusht të vitit 2015 janë paguar paga për punë ish për drejtuesit e Komunave, pas reformës territoriale për 17 punonjës në vlerën **166,430 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” ndryshuar me ligjin nr.30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar neni 75/1 ku përcaktohet se: “Organet e njësisve të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial, sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.07.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësisve të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015, i cili përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, sipas listës cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin për pagesat e përfituara më tepër nga 17 ish punonjës në vlerën 166,430 lekë gjithsej dhe të kërkojë çdëmtimin nga personat përfitues, sipas cilësimeve të bëra në faqen 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.07.2016

6. Gjetje nga auditimi: Me fletë daljen nr. 13, datë 11.09.2014 në vlerën **73,200 lekë** është tërhequr pleh kimik për nevojat e stadiumit nga z.F.D. pa kërkesë material, pa preventiv ndërkohë që ky shërbim kryhet nga vetë shoqëria e klubit “B...s” nëpërmjet fondeve që vihen në dispozicion nga Bashkia për rritjen e kapitalit.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin për pagesën e kryer për llogari të shoqërisë së klubit “B...s” dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **73,200 lekë**.

Brenda datës 30.06.2016

7. Gjetje nga auditimi: Në një rast nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 «Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore», i ndryshuar, duke sjellë që ish punonjësi D.Xh. të përfitojë padrejtësisht vlerën **35,400 lekë** për periudhën janar-prill 2013.

Rekomandim: Nga Bashkia Mallakastër të kontabilizohet detyrimi dhe të kërkohet me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimi i vlerës 35,400 lekë nga ish punonjësi D.Xh.

Brenda datës 31.08.2016

8. Gjetje nga auditimi: Në katër raste janë kryer pagesa për shpenzime lindjeje në vlerën **20,000 lekë** të pa argumentuara me dokumentacionin e rregullt justifikues, të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprim është në kundërshtim me nenin 27 pika1, nenin 42 pika 2 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin për shpërblimin e lindjes në vlerën 20,000 lekë dhe të kërkojë çdëmtimin nga katër personat përgjegjës, A.S. në vlerën 5,000 lekë, F.V. në vlerën 5,000 lekë, D.K. në vlerën 5,000 lekë dhe A.D. në vlerën 5,000 lekë.

Brenda datës 30.06.2016

9. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Financës në katër raste janë likuiduar punime me karakter ndërtimi dhe të ndryshme për llogari të punonjësve pa licencë për të cilët nuk është aplikuar tatimi mbi të ardhurat në vlerën **17,747 lekë**, në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë detyrimin për tatimin mbi të ardhurat në vlerën 17,747 lekë dhe të kërkojë çdëmtimin e vlerës 17,747 lekë nga katër personat përfitues.

Brenda datës 31.07.2016

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014 kanë rezultuar diferenca në mungesa në vlerën **108,910 lekë**, në llogarinë nr.218 “*inventar ekonomik*” të rezultuara në Shkollën e mesme, teprica gjithsej në vlerën 115,500 lekë në llogarinë nr.327 “*objekte inventari*” të rezultuara në Shkollën “*Besëlidhja*” dhe konkretisht në inventarin e shkollës në vlerën 800 lekë dhe në Bibliotekën e shkollës në vlerën 114,700 lekë.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë si detyrim vlerën **108,910 lekë** si diferencë inventari dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **108,910 lekë** nga përgjegjësi material ish drejtori i shkollës z. A.L.

Brenda datës 30.06.2016

11. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 janë asgjësuar, groposur materiale (llog.327) por që mund të përfitoheshin nga ndarja e tyre në vlerën **47,000 lekë** me natyrë hekuri si makina kapse, reflektor, shina perdes, kasaforta, çelsa, koster bari, karrike metalike, ngrohësa elektrik, karro dore etj.

Për vitin 2014 vlera e materialeve jashtë përdorimit të asgjësuar por që mund të përfitoheshin nga ndarja e tyre është **15,000 lekë** nga inventari ekonomik (218) si kalorifer, kompjutera, kasaforta, karrike, tavoline hekuri.

Rekomandim: Drejtoria e Financës, të kontabilizojë si detyrim vlerën **62,000 lekë** e materialeve jashtë përdorimit të asgjësuar por që mund të përfitoheshin nga ndarja e tyre dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 62,000 lekë nga e cila ish magazinierë F.C. në vlerën 7,750 lekë, ish magazinierë M.S. në vlerën 7,750 lekë, ish Drejtore e Financës Xh.Y. në vlerën 7,750 lekë, ish Drejtore e Financës J.A. në vlerën 7,750 lekë, ish financiere S.D. në vlerën 7,750 lekë, financiere Sh.M. në vlerën 7,750 lekë, ish komisionerët e inventarizimi S.S. në vlerën 7,750 lekë dhe H.A. në vlerën 7,750 lekë.

Brenda datës 30.06.2016

12. Gjetje nga auditimi: Komuna Qendër në vitet 2010-2012 ka lidhur marrëdhënie kontraktuale qiraje me të tretë në 69 raste në sipërfaqen 632.4 ha ku në fund të vitit 2015 u konstatua se 57 persona nuk kanë shlyer detyrimet për marrjen e tokës me qira për vlerën **740,555 lekë**.

Rekomandim: Nga ana e Titullari të njësisë publike, Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Administratori i Njësisë Administrative të kërkohet plotësimi i dokumentacionit të tokave bujqësore që janë dhënë me qira dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP.

Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Administratori i Njësisë Administrative Qendër (Dukas) të kontabilizohet detyrimi nga 57 persona në vlerën **740,555 lekë** që rrjedh nga kushtet e kontratave dhe të kërkohet arkëtimi i kamatëvonesave deri në zgjidhjen e kontratave.

Brenda datës 31.07.2016

13. Gjetje nga auditimi: Komuna Hekal në vitin 2013 ka dhënë me qira tokë bujqësore për 28 persona në sipërfaqe 74,428 ha gjithsej nga të cilët 26 persona në toka të pa ndara në sipërfaqe **33,1 ha për** mbjellje ullinj me afat për 99 vjet, 1 person për sera në sipërfaqe **0,7 ha** me afat për 35 vjet dhe 1 subjekt juridik “B...” për mbjellje plepi në sipërfaqe **32,4 ha**

pyll për 10 vjet. Në fund të vitit 2015 u konstatua se 8 persona nuk kanë shlyer detyrimet në vlerën **474,850 lekë**.

Rekomandim: Nga ana e Titullari të njësisë publike, Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Administratori i Njësisë Administrative të kërkohet plotësimi i dokumentacionit të tokave bujqësore që janë dhënë me qira dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP.

Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Administratori i Njësisë Administrative Hekal të kontabilizohet detyrimi nga 8 persona në vlerën **474,850 lekë** që rrjedh nga kushtet e kontratave dhe të kërkohet arkëtimi i kamatëvonesave deri në zgjidhjen e kontratave.

Brenda datës 31.07.2016

14. Gjetje nga auditimi: Komuna Kutë në vitet 2010-2012 ka lidhur marrëdhënie kontraktuale qiraje të tokës bujqësore me të tretë në 24 raste në sipërfaqen 25 ha ku në fund të vitit 2015 u konstatua se 9 persona nuk kanë kryer pagesën e qirasë sipas kushteve të kontratës për vlerën **266,400 lekë**.

Rekomandim: Nga ana e Titullari të njësisë publike, Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Administratori i Njësisë Administrative të kërkohet plotësimi i dokumentacionit të tokave bujqësore që janë dhënë me qira dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP.

Rekomandim: Nga Drejtoria Ekonomike dhe Administratori i Njësisë Administrative Kutë të kontabilizohet detyrimi nga 9 persona në vlerën **266,400 lekë** që rrjedh nga kushtet e kontratave dhe të kërkohet arkëtimi i kamatëvonesave deri në zgjidhjen e kontratave.

Brenda datës 31.07.2016

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij si dhe mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenit 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, fillimin e procedurave e masave disiplinore:

I. “Vrejtje” deri në “ndërprerje të marrëdhënieve të punës” si më poshtë:

1. Zj. A.B. me detyrë specialiste e Auditit të Brendshëm.

Pasi me veprimet apo mos veprimet e saj ka shkelur:

a)-ligjin nr.9720,datë 23.04.2007”Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318,datë 16.09.2010, neni 21, “Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm”, pika 4, ku parashikohet se: Auditët duhet të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, nga pikëpamja profesionale,.....,etj, pika 7- ku përcaktohet se: Ti japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë, në rastet e dëmeve ekonomike dhe financiare, për zhdëmtimin e tyre si dhe të bëjnë propozime të cilët synojnë të ulin mundësinë përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

b-Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB) të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.9.2010.

c-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 12, datë 5.6.2012” Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Pasi:

-Nuk ka realizuar kontrole në afatin e caktuar nga programet e kontrollit, konform të gjitha standarteve të kontrollit;

-Nuk ka mbajtur proces-verbal, akt-verifikim, akt-kontroll, sipas rregullave të përcaktuara në aktet ligjore për këtë fushë, duke njoftuar në moment eprorët;

-Nuk ka propozuar asnjë masa disiplinore, gjopa, apo ndjekje penale sipas rastit.

-Nuk ka përgatitur të gjitha dokumentet që duhen konform standardeve dhe metodikave në fuqi të kontrollit për evadimin dhe plotësimin e dosjes së çdo kontrolli të kryer, dorëzimin Në pesë praktika të cilat u mbikëqyrën nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se, nuk është zbatuar “Manuali i Procedurave të Auditimit, Kodi etik për auditët e brendshëm, karta e auditimit të brendshëm publik miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.9.2010.

-Në përfundim të auditimit nuk ka hartuar Memorandumi (informacion mbi përfundimet e kontrollit) edhe në disa raste që ishte përgatitur është identik me Raportin Final të Auditimit, si nga numri i fletëve dhe problematika, në kundërshtim me seksionit V, pika 5, Memorandumi.

-Përfundimet e auditimit nuk i janë bërë prezent Kryetarit të Bashkisë duke mos marrë mendimin e tij me shkrim. Problemet e nxjerra nuk trajtohen në mënyrë të përmbledhur (konçize) në raportin final, duke e bërë të vështirë për titullarin në marjen e informacionit dhe në vendimarrje.

-Pas shqyrtimit të praktikës së auditimit, nuk hartohet shkresa e evadimit, e cila nuk i është dërguar zyrtarisht subjektit të audituar, duke mos e shoqëruar dhe me Raportin final të auditimit edhe në ato raste kur raporti final është dërguar dorazi pa u shoqëruar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, nuk kishte konfirmim zyrtar të Raportit Final të Auditimit, nga subjekti i kontrolluar.

-Nuk ka zbatuar Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 12, datë 5.6.2012” Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

2. Zj. Sh.M. me detyrë specialiste e financës.

Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të vlerave materiale në vitin **2015**, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Kreun IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pikën 73 dhe 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve një njësiti e sektorit publik”.

-Për mos pasqyrimin në kontabilitet dhe mos ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve që rjedhin nga mungesat në inventarizimin e vlerave materiale për vitin 2014 në 8 (tetë) shkollat e ish Komunave Mallakastër në vlerën **729,867 lekë** gjithsej, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

-Për **kalimin në rezultat** të diferencave në mungesa inventarizimi të vlerave materiale për vitin 2013 në vlerën **1,297,551 lekë** gjithsej nga e cila në llogarinë 327 “objekte inventari” në vlerën 738,764 lekë, për llogari të shkollës së mesme dhe në llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerën 558,787 lekë, nga e cila për llogari të shkollës së mesme në vlerën 514,447 lekë dhe shkollës 9 vjeçare “5 Shkurti” në vlerën 44,340 lekë.

-Për asgjësimin e vlerave materiale në vitin 2013 (llog.327) me natyrë hekuri si makina kapse, reflektor, shina perdes, kasaforta, çelsa, koster bari, karrike metalike, ngrohësa elektrik, karro dore etj. dhe në vitin 2014 (218) si kalorifer, kompjutera, kasaforta, karrike, tavoline hekuripor që mund të përfitoheshin nga ndarja e tyre në vlerën **62,000 lekë** gjithsej. Megjithëse për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale nga vjedhja dhe dëmtimet si më sipër, titullari i Bashkisë me datë 25.07.2013 ka ngarkuar Përgjegjësin e Policisë Bashkiake dhe Përgjegjësin e Shërbimeve Publike për të bërë edhe kallëzim në organet kompetente, vlerat materiale kanë kaluar në rezultat, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

II. “Ndërprerje e menjëhershme të marrëdhënieve të punës” si më poshtë:

1. Z.N.M. me detyrën e ish përgjegjësit të zyrës së tatim taksave për periudhën 02.05.2013 deri në 01.04.2014 dhe ish specialist i zyrës së taksave për periudhën 01.04.2014 deri në 07.08.2015, në përbërjen e KVO në përbërjen e KBV.
në përbërjen e Njesisë së Prokurimit dhe KBV.

2. Z.J.M. me detyrë ish inspektor i tatim taksave për periudhën 01.05.2013 deri në 31.03.2014 dhe ish përgjegjës i zyrës së taksave për periudhën 01.04.2014 deri në 07.08.2015, në përbërjen e KVO në përbërjen e KBV.

3. Z. A.D. me detyrë ish inspektor i tatim taksave për periudhën 01.01.2013 deri në 28.09.2015,

4. Z. B.A. me detyrë ish inspektor i tatim taksave për periudhën 01.05.2013 deri në 28.09.2015.

-Për moskrijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjarë, për taksën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe ndërtesës, duke vepruar në kundërshtim me pikën 7, neni 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

-Për mos evidentimin e saktë të debitorëve, mosndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, ndriçimit, pastrimit, gjelbërimit, tabelës, ndërtesës, ndotjes dhe therjes. Sipas periudhës së qëndrimit në detyrë, nga mosndjekja e procedurave të mësipërme personat janë përgjegjës si më poshtë:

Këto veprime janë në kundërshtim me kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me detyrën funksionale të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

-Për mos dorëzim të detyrës me procesverbal, duke vepruar në kundërshtim me pikën 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5. Zj. Xh.Y. me detyrën e ish drejtorit të financës dhe nëpunësit zbatues për periudhën 01.01.2013 deri në 02.12.2013, në cilësinë e kryetarit të KBV.

- 6. Zj. J.A.** me detyrën e ish drejtorit të financës dhe nëpunësit zbatues për periudhën nga 02.12.2013 deri 28.09.2015 dhe specialiste e financës deri në 11.03.2016, në cilësinë e kryetarit të KBV dhe anëtarit të KVO.
- 7. Zj. S.D.** me detyrë ish specialiste e financës deri në 09.01.2016.
- 8. Z.E.I.** me detyrë ish specialist në zyrën financës në përbërjen e KVO.
- Për hartimin e buxhetit tej afateve ligjore të përcaktuara me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në kërkesat e nenit 19, pika 4 dhe 5 *“Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore”*, ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* dhe nenin 32 *“Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor”* të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*
 - Pasi në hartimin dhe miratimin e buxhetit nuk janë përllogaritur detyrimet afatshkurtra të Bashkisë ndaj të tretëve për 454 subjekte kreditore në vlerën 69,197 mijë lekë dhe detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë për 318 subjekte debitore në vlerën 751,868 mijë lekë, veprim në kundërshtim me Kreun II *“Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve”* neni 6 *“Evidenca mbështetëse”* pika 1 dhe 2 dhe neni 7 *“Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”* pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar
 - Për mos kuadrumin e bilancit kontabël të vitit 2013 në vlerën 2,547,834 lekë, diferencë e konstatuar në Klasa 4 **“Detyrime”** dhe konkretisht në llogarinë sintetike nr.466 *“Kreditor për mjete në ruajtje”* e sistemuar nga jashtë në bilancin e vitit 2014.
 - Për pasqyrimin padrejtësisht në llogarinë nr.467 *“Kreditorë të ndryshëm”* kur duhej pasqyruar në llogarinë nr.468 *“Debitor të ndryshëm”*, veprim në kundërshtim me Kreun II *“Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve”* neni 6 *“Evidenca mbështetëse”* pika 1 dhe 2 dhe neni 7 *“Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”* pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar
 - Për mos rivlerësimin e mjeteve themelore, ndërtesa, të cilat janë regjistruar në kontabilitet me vlerë fillestare të tyre me çmimet e vjetra pa u bërë rivlerësimi i tyre, veprim në kundërshtim me Kreun II *“Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve”* neni 6 *“Evidenca mbështetëse”* pika 1 dhe 2 dhe neni 7 *“Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”* pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar dhe objektet e ndërtesave nuk janë regjistruar në ZVRPP.
 - Për mangësitë në dokumentacionin bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla ku mungonte kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.
 - Për mangësitë e konstatuara në kryerje pagesash për blerje në vlera të vogla apo kryerje shërbimesh dhe aktivitete të ndryshme me tejkalim limitesh mbi vlerat e lejuara në vit për një artikull ose grup artikujsh.
 - Për mos pasqyrimin në kontabilitet dhe mos ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nga viti 2013 për taksat dhe tarifat vendore nga 318 subjekte në vlerën 751,868 mijë lekë , veprim në kundërshtim me Kreun II *“Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve”* neni 6 *“Evidenca mbështetëse”* pika 1 dhe 2 dhe neni 7 *“Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”* pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar
 - Për mos kryerjen e inventarizimit fizik të vlerave materiale në vitin **2015**, veprim në kundërshtim me Kreun II *“Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e*

detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Kreun IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pikën 73 dhe 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve një njësitë e sektorit publik”.

-Për mos pasqyrimin në kontabilitet dhe mos ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve që rjedhin nga mungesat në inventarizimin e vlerave materiale për vitin 2014 në 8 (tetë) shkollat e ish Komunave Mallakastër në vlerën **729,867 lekë** gjithsej, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

-Për **kalimin në rezultat** të diferencave në mungesa inventarizimi të vlerave materiale për vitin 2013 në vlerën **1,297,551 lekë** gjithsej nga e cila në llogarinë 327 “objekte inventari” në vlerën 738,764 lekë, për llogari të shkollës së mesme dhe në llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerën 558,787 lekë, nga e cila për llogari të shkollës së mesme në vlerën 514,447 lekë dhe shkollës 9 vjeçare “5 Shkurti” në vlerën 44,340 lekë.

Megjithëse për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale nga vjedhja dhe dëmtimet si më sipër, titullari i Bashkisë me datë 25.07.2013 ka ngarkuar Përgjegjësin e Policisë Bashkiake dhe Përgjegjësin e Shërbimeve Publike për të bërë edhe kallëzim në organet kompetente, vlerat materiale kanë kaluar në rezultat, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

9. Z. H.M. me detyrë ish Shef i Policisë së Bashkisë deri më 27.03.2016:

- Për mos realizimin e detyrave funksionale si: të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të Bashkisë si dhe të organizojë lirimimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me nenin 8, pika 6 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”

-Për mos ndjekjen dhe kalimin në rezultat të diferencave në mungesa inventarizimi të vlerave materiale për vitin 2013 në vlerën **1,297,551 lekë** gjithsej nga e cila në llogarinë 327 “objekte inventari” në vlerën 738,764 lekë, për llogari të shkollës së mesme dhe në llogarinë 218 “inventar ekonomik” në vlerën 558,787 lekë, nga e cila për llogari të shkollës së mesme në vlerën 514,447 lekë dhe shkollës 9 vjeçare “5 Shkurti” në vlerën 44,340 lekë.

Megjithëse për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale nga vjedhja dhe dëmtimet si më sipër, titullari i Bashkisë me datë 25.07.2013 ka ngarkuar Përgjegjësin e Policisë Bashkiake dhe Përgjegjësin e Shërbimeve Publike për të bërë edhe kallëzim në organet kompetente, vlerat materiale kanë kaluar në rezultat, veprim në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” neni 6 “Evidenca mbështetëse” pika 1 dhe 2 dhe neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,

10. Z. E.M. me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës deri në Maj 2015 në cilësinë e anëtarit të KVO.

11. Z. H.S. me detyrë ish përgjegjës i zyrës së urbanistikës deri në 09.12.2015.

12. Z. E.B. me detyrë ish specialist në zyrën e urbanistikës në përbërjen e KVO.

13. Zj. E.N. me detyrë ish specialiste në zyrën zyrën e urbanistikës në cilësinë e anëtarit të KVO.

14.Z. B.F. me detyrë ish specialist për mardhëniet me publikun në përbërjen e Njësisë së Prokurimit.

-Për miratimin e lejes zhvillimore infrastrukture nr. 1, datë 19.02.2015, për punimet: *“Sistemim i rrugëve të brendshme dhe gjelbërimi i blloqeve të banimit në qytetin e Ballshit”*, në kushtet kur nuk është kërkuar dhe nuk është marrë kontrolli i përputhshmërisë të lejes zhvillimore nga AKPT, për të cilën nuk është njoftuar dhe KKT, veprime këto në kundërshtim me pikën 2 të Vendimit nr. 8, datë 07.11.2014 të KKT, *“Për miratimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi”*

-Për miratimin e lejes zhvillimore me vendimin e KRRT-së nr. 4 datë 07.11.2008 për subjektin ndërtues “ASI” për objektin lokal + banesë, në dosje mungon çertifikata e pronësisë, kontrata që duhet të ishte lidhur me pronarin e truallit, ose personin i cili ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja, veprime këto në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 2 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 *“Për urbanistikën”* i ndryshuar.

15. Z. E.P. me detyrë ish Kryeinspektor INUV, në cilësinë e anëtarit të KVO deri 09.03.2016

16. Z. E.J. me detyrë ish Jurist specialist INUV në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit deri në 09.12.2015.

-Për 6 raste vendime pezullimi, për kryerje punime pa leje ndërtimit, nuk ka aplikuar gjobë, në shumën 300.000 lekë secili, në total 1.800.000 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar, veprime këto në kundërshtim me seksionin VII neni 82, pika 8 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, i ndryshuar.

-Për 2 vendime prishje, për kryerje punime pa leje ndërtimit edhe pas afatit 10 ditore, nuk ka aplikuar gjobë, në shumën 500.000 lekë secili, në total 1.000.000 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar veprime këto në kundërshtim me:

- pikën 8 të Vendim nr.862, datë 5.12.2007 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor i ndryshuar me: Vendim nr. 625, date 28.7.2010,*

- pikën 8 të Vendimit nr. 846, datë 27.10.2010, në kundërshtim me neni 52 shkronja (e) ligjit nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*.

- Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Mallakastër, nuk kanë bashkëvepruar dhe bashkërenduar veprimet inspektuese ndërmjet policisë Bashkiake dhe me autoritetet e planifikimit, kur në dijeni të fakteve, autoritetet e inspektimit nuk rezultojnë të ketë njoftuar autoritetin tjetër përgjegjës, pasi: Për ndërtimet/ shtesat e kundërligjshme të cilat janë evidentuar nga verifikimi në terren të bërë të pronave publike në pronësi/ përdorim të Bashkisë Mallakastër, si dhe nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë veprime kryesisht, si vendosja e gjobave sipas llojit të shkeljeve në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, veprime këto në kundërshtim me:

- seksionin VII, neni 81 pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, i ndryshuar,

-nenin 5, pika d, dh, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për inspektimin e ndërtimit”* i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.12.2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin e ndërtimit”*.

-pikat b, ii), iii) të Vendimit KM nr. 862, datë 5.12.2007 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”* .

Shënim: Për punonjësit e larguar nga puna të sipërsënuar masa disiplinore e rekomanduar do të ishte “Ndërprerje e menjëhershme të marrëdhënieve të punës”, pasi shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur më sipër nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Mallakastër dhe nuk kanë adresim institucional për dhënien dhe ndjekjen e zbatimit të masës disiplinore. Në kushtet kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e punonjësve ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, për këtë ngarkohet që Bashkia të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për rezultatet e auditimit të KLSH për këta persona dhe marrjen e masave të mëtejshme nga ana e saj.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. datë 09.02.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), pesë punonjësve si më poshtë:**

1. Z. **A.R.** me detyrë drejtor ekonomik në cilësinë e kryetarit të KVO,

2. Z. **L.XH.** me detyrë jurist INUV, në cilësinë e anëtarit të KVO:

a- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Princi Boris”, kanë kualifikuar operatorin ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Z. **R.M.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

4. Z. **B.O.** me detyrë përgjegjës i Sektorit të PMZHT në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

5. Z. **N.S.** me detyrë përgjegjës i Sektorit Juridik në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

a- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Princi Boris”, nuk është respektuar parimi i mos diskriminimit, duke vendosur kërkesa specifike, që nuk mundësojnë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve, veprimet këto në kundërshtim me kreun III neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

b- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje karburanti D1, për mjetet e Bashkisë”, nuk është i dokumentuar argumentimi i llogaritjes së vlerës së kontratës, veprime këto në kundërshtim me kreun VII, neni 59, pikat 1, 2, shkronjat a, b, c të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nuk është respektuar parimi i mos diskriminimit, duke vendosur kërkesa specifike, që nuk mundësojnë

pjesëmarrje të gjerë të operatorëve, veprimet këto në kundërshtim me kreun III neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për:

- 1. R.SH.** me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Ballsh dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 2. J.A.** me detyrë Drejtor Finance i Bashkisë Ballsh dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 3. E.N.** me detyrë Specialiste e Urbanistikës në Bashkinë Ballsh dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 4. E.I.** me detyrë Specialist Finance në Bashkinë Ballsh dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 5. J.M.** me detyrë Specialist i Taksave Vendore në Bashkinë Ballsh dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 6. K.A.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO.
 - 7. S.D.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO
 - 8. H.M.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO,
- pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

E.1 INDICIE PËR KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të Kodit Penal, përcillen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Fier, Indiciet Penale për:

- 1. S.D.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 2. SH.RR.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO.
- 3. N.N.** ish-punonjësi i Komunës Fratar, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për procedurën e prokurimit “Ndërtim kopshti 1 kat, Komuna Fratar, Mallakastër”, nga ku ka rezultuar se operatori ekonomik i shpallur fitues, nuk ka plotësuar një sërë kriteresh kualifikuese, duke qenë në kushte të barabarta me 4 operatorë të tjerë ekonomik të skualifikuar po për mungesë të mosplotësimit të kriterëve kualifikuese.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R